

# PUNA SOCIALE NË TRAJTIMIN E RASTEVE TË DHUNËS ME BAZË GJINORE

Personat LGBTQI

QENDRA PËR BARAZI DHE LIRI TË KOMUNITETET LGBT NË KOSOVË (CEL)

COPYRIGHT © CENTRE FOR EQUALITY AND LIBERTY TË GJITHA TË DREJTAT E REZERVUARA. ASNJË PJESE E KËTIJ PUBLIKIMI NUK MUND TË RIPRODHOHET, TË RUHET OSE TË TRANSMETOHET NË ÇFARËDO FORME ELEKTRONIKE, MEKANIKE FOTOKOPJUESE, INCIZUESE APO NDRYSHE, PA LEJEN PARAPRAKE TË CEL KOSOVA.

CEL. Tel: +383 49 701 499  
e-mail: [info@cel-ks.org](mailto:info@cel-ks.org)  
web-page: [www.cel-ks.org](http://www.cel-ks.org)

AUTOR: Dr. Rita Selimi

Klauzolë e përgjegjësisë

Ky manual është mbështetur nga Komuna e Prishtinës. Mendimet e shprehura në këtë publikim nuk reflektojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Komunës së Prishtinës.

# Përmbledhje

Manuali “Puna Sociale në Trajtimin e Rasteve të Dhunës me Bazë Gjinore: Personat LGBT+” ka për qëllim të elaborojë më gjerësisht konceptin e dhunës në bazë gjinore duke u fokusuar te personat LGBT+, të ofrojë një vështrim mbi kornizat teorike mbi punën sociale në trajtimin e këtyre rasteve si dhe të identifikojë mënyrat më të mira mbështetëse. Në literaturën bashkëkohore mbi dhunën me bazë gjinore, kjo kategori dhune përkufizohet si **çdo akt i kryer kundër një individi mbi bazën e gjinisë ose identitetit të tij gjinor, që rezulton ose mund të rezultojë në dëm fizik, seksual ose psikologjik, duke përfshirë edhe kufizimin e lirisë** (UN Women, 2020). Në kontekstet social-kulturore me histori të luftës të cilat kanë norma më të rrepta sociale (Kitayama et al., 2024), shumë shpesh kategoritë shoqërore që nuk përkojnë me imazhin heteronormativ të përcaktuar, përndjeken dhe janë pre e përjashtimit social. Kësisoj, personat LGBT+ janë më të predispozuar për tu ballafaquar me situata të dhunës ku kjo dhunë mund të shfaqet në forma të ndryshme, duke përfshirë diskriminimin sistematik, stigmatizimin, dhunën fizike dhe psikologjike, si dhe mungesën e qasjes në shërbime sociale/mbështetëse adekuate.

Për shkak të normave sociale heteronormative, frikës nga stigmatizimi, mospranimi apo mungesën e mekanizmave të specializuar për adresimin e rasteve, dhuna e ushtruar ndaj personave LGBT+ shpesh nuk raportohet ose nuk trajtohet në mënyrë adekuate. Kjo situatë rëndon situatën duke i bërë personat LGBT+ më të predispozuar për të rënë në rreth vicioz të marginalizimit, duke çuar në përkeqësim të mirëqenies psiko-sociale dhe kufizim të qasjes në shërbime sociale. Në Kosovë, pavarësisht pse të drejtat e njeriut janë të garantuara në kornizat ligjore, në realitet ende ka paragjykime dhe diskriminim ndaj personave LGBT+.

Raportet ekzsituase tregojnë se ekziston një përqindje e konsiderueshme e personave LGBT+ në Kosovë që përjetojnë (kanë përjetuar) dhunë (World Bank, 2018; NDI, 2015), dhe që të mbijetuarët e dhunës në bazë gjinore shpesh nuk raportojnë dhunën atë për shkak të frikës nga stigmatizimi (ILGA, 2011) ose sfidave social-ekonomike (KCSS, 2024). Rrjedhimisht, situata në Kosovë na tregon që krijimi i manualeve të tilla që i shërbejnë profesionistëve në ngritjen e njohurive dhe kompetencave për punën me rastet LGBT+ është i domosdoshëm. Në manualin "Fuqizimi i punëtorëve social për të ofruar shërbime sociale personave LGBTI" publikuar nga CSGD (2024) theksohet rëndësia e specifikave dhe metodologjisë në punën me rast (case management) të personave LGBT+, po ashtu nevoja për krijimin e manualeve tjera mbështetëse që trajtojnë tema specifike të rasteve LGBT+. Rrjedhimisht, krijimi i këtij manuali plotëson literaturën ekzsituase dhe ndihmon profesionistët e shërbimeve sociale në trajtimin e rasteve të dhunës me bazë gjinore ndaj personave LGBT+.

Duke marrë parasysh qasjet të punës sociale, si teoria e sistemeve (Bronfenbrenner, 1979), modeli i forcave (strengths-based approach) (Saleebey, 1996) apo teorinë e ndërgjegjësimit ndaj traumës, ky manual ofron vështrim mbi qasjet teorike dhe praktike për shërbimet dhe intervenimet në punën me rastet që përjetojnë dhunë në bazë gjinore. Qëllimi i manualit është të ngris dhe plotësojë njohuritë dhe kompetencat e profesionistëve për të kuptuar/adresuar sfidat, nevojat dhe për të ofruar shërbime.

# Përmbajtja e manualit

Manuali është ndërtuar mbi qasje teorike dhe empirike që mundëson lexuesin të njeh, kuptojë, aplikojë teoritë në punën praktike me të mbijetuarit e dhunës në bazë gjinore si dhe ndihmon praktikisht profesionistët për adresimin e çështjeve të dhunës me bazë gjinore.

Përmes manualit, do të trajtohen nën temat si:

- Konceptet kyçe të dhunës me bazë gjinore në rastet e personave LGBT+.
- Modelet e intervenimeve të punës sociale, të cilat bazohen në qasjet e mbështetjes psiko-sociale dhe fuqizimit të të mbijetuarëve.
- Praktikat më të mira për identifikimin, trajtimin dhe referimin e rasteve në rastet e dhunës në bazë gjinore për LGBT+

Ky manual përveç se shërben si burim i informayave, poashtu bën thirrje për veprim, duke nxitur institucionet dhe profesionistë të angazhohen në krijimin e një sistemi më gjithëpërfshirës për personat LGBT+. Qëllimi i manualit është që të plotësojë praktikën profesionale të ofrimit të shërbimeve sociale, duke theksuar vlerat e drejtësisë sociale dhe gjithëpërfshirjes si të padiskutueshme për punën sociale.



# Hyrje

## Konceptet kyçe të dhunës me bazë gjinore në rastet e personave LGBT+

Dhuna me bazë gjinore vie nga pabarazitë në raportet e pushtetit dhe ka për qëllim nënçmimin dhe uljen e dinjitetit të një individi ose grupi, duke i bërë ata të ndihen të pafuqishëm për situatën e tyre. Lloji i tillë i dhunës mirëmbahet në shoqëri pasi që shpesh internalizohet aq thellë në bindjet, qëndrimet dhe vlerat individuale, sidomos në shoqëritë patriarkale, kjo lloj dhune nënkupton një sjellje tipike të abuzimit me dominancën (Pandea, Grzemny & Keen, 2019). Për të kuptuar më mirë se çka ngërthen dhuna në bazë gjinore, ajo mund të definohet si *“çdo akt i kryer kundër një individi mbi bazën e gjinisë ose identitetit të tij gjinor, që rezulton ose mund të rezultojë në dëm fizik, seksual ose psikologjik, duke përfshirë edhe kufizimin e lirisë”*.

Në sferën akademike, historikisht, problematika e dhunës me bazë gjinore (GBV) është analizuar përmes teorive feministe dhe sociologjike, por ndonjëherë përvojat e identiteteve LGBT+ në raport me dhunën kanë mbetur nën hije pasi që fokusi kryesor kanë qenë gratë cisgjinore. Prandaj, për të elaboruar dhe kuptuar dhunën në bazë gjinore në mënyrë më gjithëpërfshirëse, janë zhvilluar disa teori që marrin parasysh ndërthurjen e identitetit gjinor, orientimit seksual dhe shtypjes sistematike që i bëhet këtyre grupeve. Një ndër kornizat teorike më gjithëpërfshirëse për të shpjeguar këtë është Teoria e Ndërthurjes (Intersectionality) nga Kimberlé Crenshaw (1989) që shpjegon mënyrën se si identitetet e shumëfishta (gjinia, seksualiteti, raca, klasa) ndërveprojnë mes tyre dhe se si përmes këtij ndërveprimi bëhemi më të predispozuar ndaj shtypjes, përjashtimit, stigmatizimit dhe mospranimit. Crenshaw krijoi këtë teori si rezultat i një ngjarjeje në SHBA ku një grua me ngjyrë përjetoi diskriminim në vendin e punës për shkak se dy identitetet e saj: të qenurit grua dhe të qenurit me ngjyrë ishin identitete të cënueshme dhe që e bënë atë të predispozuar për të përjetuar ngjarje negative/përjashtuese.

Rrjedhimisht, kjo teori argumenton se ballafaqimi me çfarëdo lloj shtypje dhe përjashtimi për individë/grupe të caktuar nuk mund të analizohet duke marrë parasysh vetëm një kategori identitare, por duhet të konsiderohet mënyra se si përmes ndërveprimit të këtyre faktorëve bëhemi cak për ballafaqim me situata shtypëse. Në mënyrë që dhuna në bazë gjinore ndaj personave LGBT+ të kuptohet në spektër më të gjerë është zhvilluar teoria mbi Kriminologjinë Queer (Buist & Lenning, 2016) që argumenton se personat queer kur kanë eksperiencë me sistemin e drejtësisë, shpesh herë vetë sistemi i drejtësisë i paragjykon apo i kriminalizon identitetet queer dhe kjo pastaj shpie deri në viktimizim të dyfishtë. Kësisoj, personat LGBT+ shpesh nuk raportojnë dhunën për shkak të mosbesimit në autoritetet dhe përvojave negative që kanë dëgjuar. Tjetër teori është Teoria e Stresit të Pakicave (Meyer, 2003) që na ndihmon për të kuptuar dhunën në bazë gjinore ndaj individëve LGBT+ dhe mënyrën se si ndikon ajo në mirëqenim psiko-sociale. Sipas kësaj teorie, kur personat, për shkaqe të mendësisë heteronormative dhe përjashtuese që mbizotëron në raport me identitetet e marginalizuara, ballafaqohen me situata sistematike të diskriminimit, stigmës dhe përjashtimit shoqëror, ata krijojnë stres kronik që rezulton në përjetim të vështirësive të shëndetit mendor. Studimi i Llullaku & Selimi (2023) tregon se në Kosovë, personat LGBT+, pjesëmarrës në studim raportuan nivele të moderuara deri në të larta të depresionit, ankthit dhe stresit, ku të njëjtat këto kishin korelacion me stigmën sociale që përjetonin këta individë.

Ky model i Meyer (2003) pastaj u zgjerua nga Testa et al. (2015) me Modelin e Stresit të Pakicave Gjinore dhe Reziliencës, e që fokusohet tek identitetet jo-binare dhe thekson se mospërputhja e këtyre identiteteve me normat dhe pritshmëritë kulturore që një kontekst ka për gjininë shpie deri tek ekspozimi më i madh për dhunë në bazë gjinore rrjedhimisht shëndet mental më të cenuar.



Një tjetër teori që trajton poashtu gjininë është Teoria e Performativitetit Gjinator (Butler, 1990) që argumenton se gjinia është konstrukt shoqëror që ndërtohet e mirëmbahet nga pritshmëritë shoqërore e jo kategori e pandryshueshme. Rrjedhimisht, shpesh herë, kur ekzistenca e një grupit të caktuar sfidon normat gjinore që shoqëria ka krijuar, atëherë këto grupe vendosen në margjina të shoqërisë dhe etiketohen si "të pa pranueshëm". Në këtë formë, dominimi dhe kontrolli shoqëror bëhet duke përdorur dhunën në bazë gjinore si mjet për të ndëshkuar ata që prishin rolet tradicionale gjinore dhe për të mirëmbajtur heteronormativitetin dhe binaritetin gjinator.

Pavarësisht se teoritë feministe kanë krijuar bazën për mënyrën se si kuptojmë dhe analizojmë dhunën në bazë gjinore, zgjerimi i teorive për të përfshirë identitetet tjera jo-binare gjinore apo orientimet seksuale jo heteroseksuale na ndihmojnë që të kuptojmë më rrënjësisht strukturën dhe dinamikën që mundësojnë apo sjellin dhunën në bazë gjinore. Rrjedhimisht, ideja e teorive nuk është vetëm përshkrimi empirik mbi çështjen por edhe fuqizimi i personave për të avokuar dhe mobilizuar për sfidimin e mendësisë dhe status-quon që mundëson cenimin e identiteteve të caktuara.

Dhuna në bazë gjinore shpesh herë mbetet e pa vërejtur për shkak se paraqitet në forma të ndryshme. Ndër format e dukshme dhe tipike është dhuna fizike që manifestohet me agresivitet, rrahje apo dëmtime trupore. Dhuna seksuale përfshin përdhunimin, ngacmimet seksuale dhe forma të tjera të dhunës seksuale që cenojnë integritetin e individit. Dhuna psikologjike dhe emocionale manifestohet përmes kërcënimeve, manipulimeve dhe izolimit social. Poashtu, formë tjetër është dhuna ekonomike, e cila përfshin kontrollin financiar dhe kufizimin e qasjes në burime ekonomike. Për personat LGBT+, përjetimi i formave të lartëpërmendura të dhunës, sidomos në vendet me dominancë heteronormative është tejet prezente.

# Modelet e intervenimeve të punës sociale në trajtimin e rasteve të dhunës me bazë gjinore

Modelet e intervenimeve të punës sociale në trajtimin e rasteve të dhunës me bazë gjinore ndërtohen nga kornizat teorike që nisen nga premisat e mbrojtjes sociale, rehabilitimi, trajtimi i pasojave të dhunës si dhe krijimit të faktorëve mbrojtës e reziliencës tek të mbijetuarit. Gjithë modelet me doemos bazohen në parimet etike të punës sociale si drejtësia sociale, vetëvendosja, njohja dhe respektimi i diversitetit poashtu të drejtat e njeriut si pjesë fundamentale e çdo lloj intervenimi. Një nga modelet më të aplikueshme për rastet e dhunës është modeli i ndërhyrjes së menjëhershme (Crisis Intervention Model) që fokusohet në sigurimin e mbështetjes emergjente. Kjo ndërhyrje përfshin adresimin e nevojave emergjente si psh. ofrimin e strehimit të sigurt, mbështetje psikologjike dhe ligjore, si dhe referimin tek institucionet e drejtësisë për të përfituar urdhërbrojtje. Punëtorët socialë kanë rol të rëndësishëm në këtë pikë pasi që veprojnë si ndërmjetësues mes rasteve dhe sistemit të mbrojtjes sociale, poashtu duke u siguruar që rastet të kenë qasje adekuate në shërbime që adresojnë dëmin e shkaktuar nga përjetimi i dhunës (Heath et al., 2020; Cookson et al., 2004). Kjo qasje tregon për rëndësinë e bashkëpunimit të gjithë akterëve në sistem për të siguruar shërbime gjithëpërfshirëse dhe trajtim efektiv.

Një tjetër model i rëndësishëm është modeli i ndërhyrjes me bazë komunitare (Community-Based Intervention Model), model ky që thekson fuqizimin dhe mobilizimin aktiv të komunitetit për të luftuar dukuritë negative, si dhe ngritjen e resurseve në komunitet për të ndërtuar kulturë të mbështetjes dhe reagimit kolektiv. Programet e tilla do përmbanin format si aktivizmi social në komunitet, krijimi i grupeve mbështetëse, organizimin e fushatave ndërgjegjësuere për të sfiduar normat patriarkale dhe ndërtimin e rrjeteve të bashkëpunimit mes organizatave të shoqërisë civile, institucioneve shtetërore dhe akterëve të tjerë relevantë. Në këtë rast, punëtorët socialë nuk janë vetëm ofrues të shërbimeve, por edhe avokues të ndryshimeve shoqërore, duke promovuar politika dhe iniciativa që reduktojnë shtypjen dhe abuzimin (Hyman, 1990).

Qasje tjetër mjaft e rëndësishme është qasja multidisiplinare (Multidisciplinary Approach Model), një model qëkërkon bashkëpunimin e akterëve të ndryshëm në sistem për të siguruar që të ofrohet trajtim sa më holistik në raport me nevojat e të mbijetuarve. Kësisoj, në mënyrë që rezultatet e punës sociale të jenë të qëndrueshme, pinëtorët socialë duhet të jenë në kordinim me profesionistët e fushave tjera si psikologët, mjekët, policinë, juristët dhe organizatat e shoqërisë civile për të garantuar që rastet të marrin mbështetje dhe shërbime efektive (BASW, 2018). Në përgjithësi, modelet e intervenimeve të punës sociale në trajtimin e rasteve të dhunës me bazë gjinore duhet t'i përshtaten nevojave të komuniteteve dhe të bazohen në parimet e drejtësisë sociale dhe fuqizimit. Përveç modeleve të lartëshënuara, në pjesën në vazhdim do elaborohen teoritë e punës sociale dhe aplikimi i tyre praktik në trajtimin e rasteve të dhunës në bazë gjinore.

## **Teoria e sistemeve e Bronfenbrenner-it (Ecological Systems Theory, 1979)**

Urie Bronfenbrenner (1979) zhvilloi qasjen ekologjike/teorinë e sistemeve, teori kjo e cila ka objekt studimi procesin e zhvillimit të njeriut. Kjo qasje teorike thekson se faktorët apo nivelet e ndryshme të sistemit luajnë rol në mënyrën si i përjetojmë gjërat dhe si formohemi. Pavarësisht pse shumë procese të zhvillimit kanë karakteristika që janë pothuajse universalisht të ngjashme, teoria shpjegon se arsyeja pse ne formohemi, sillemi, reagojmë, përjetojmë ndryshe edhe pse kemi kaluar në procese zhvillimore të ngjashme me tjerët është fakti se ndërveprimi i niveleve të sistemit tek ne ka qenë ndryshe. Pra, zhvillimi dhe sjellja e individit vie si rezultat i ndërveprimit të faktorëve të ndryshëm në sistem.

Bronfenbrenner kishte identifikuar disa nivele të sistemeve të cilat ekzistojnë ndaras por poashtu ndërveprojnë me njëra-tjetrën duke ndikuar realitetin tonë. Rrjedhimisht, situatat kaotike në një sistem të caktuar, vështirësojnë zhvillimin optimal në sistemet tjera. Shembull, një fëmijë që në rrethin e tij familjar ballafaqohet me varfëri, neglizhim, përjashtim, e ka të vështirë funksionimin në gjitha nivelet tjera. Kësisoj, kjo qasje tregon që procesi i zhvillimit dhe trajtimit të çështjeve duhet të jetë më gjithëpërfshirës, që një problem me të cilin përballet njeriu nuk duhet të trajtohet i veçantë vetëm në nivelin e sistemit që përket por si rezultat duhet të shihen dhe pasojat që ka shkaktuar në nivelet tjera. Në punë sociale, kjo teori është një ndër kornizat më të përdorura pasi që puna sociale nisat me idenë që përmisimi i mirëqenies sociale dhe tejkalimi i situatës së vështorë arrihet vetëm përmes intervenimit holistik në gjithë faktorët, por gjithashtu teoria na ndihmon në parandalim duke qenë që dëshmon që faktorët mjedisorë luajnë rol në predispozitat individuale për tu ballafaquar me probleme emocionale dhe sjelljes.

Në raport me çështjen e dhunës me bazë gjinore ndaj personave LGBT+, kjo kornizë teorike na ndihmon për të kuptuar se si duhet të kuptohet dhe adresohet kjo çështje në gjithë nivelet e sistemeve, poashtu se cilat janë intervenimet që duhet bërë në mënyrë që të ketë ndryshime përmbajtësore.

## **Nivelet e teorisë së sistemeve janë:**

**1.Mikrosistemi:** Ky nivel fokusohet tek mjedisi më i afërt i individit, si familja, miqtë, shkolla dhe komuniteti i ngushtë (Berk, 2000). Ky nivel është niveli primar, më i afërt dhe që ka ndikimin më të drejtpërdrejtë tek individët pasi që përfshin agjensët e parë të socializimit që formojnë personalitetin dhe sjelljen e individit (Bronfenbrenner, 1986). Në rastin e personave LGBT+, familjet shpeshherë mund të jenë burim i mbështetjes ose i dhunës dhe përjashtimit. Studimet (Ryan, Huebner, Diaz, & Sanchez, 2009) kanë treguar se refuzimi nga familja ndikon drejtpërdrejt në rritjen e stresit dhe rrezikun për depresion dhe tentativa vetëvrasëse.

**2.Mezosistemi:** Ky nivel fokusohet tek ndërveprimet midis mikrosistemeve, pra ndërlidhjet e strukturave të individit, si për shembull ndikimi i shkollës, mësuesve apo miqve në marrëdhëniet familjare.

**3.Ekzosistemi:** Ky nivel fokusohet tek struktura shoqërore më të gjera që ndikojnë indirekt mbi individin, si ligjet, mediat dhe institucionet. Në shumë vende, politikat dhe ligjet diskriminuese kontribuojnë në dhunën me bazë gjinore ndaj personave LGBT+ (Herek, 2009).

**4.Makrosistemi:** Ky nivel fokusohet tek aspekti kulturor, ideologjitë dhe bindjet që mirëmbahen nga shoqëria e që në rastin e personave LGBT+, studimet tregojnë se për shkak të paragjykimeve ekziston stigma shoqërore çon në përjashtim social dhe dhunë sistematike (Meyer, 2003).

**5.Kronosistemi:** Ky nivel fokusohet në ndikimin e kohës mbi përvojat e individit. Ka dy lloj faktorë që ndikojnë këtë, të jashtëm apo të brendshëm, shembull tek faktorët e jashtëm nënkuptohen situatat që ndodhin jashtë kontrollit të individit ndërsa tek faktorët e brendshëm janë ndryshimet që ndodhin tek individi. Të dy këto ndikojnë me kohë se si reagojmë ndaj situatave të ndryshme (Berk, 2000).

# Ushtrime

## Rast studimi

Elira është një vajzë transgjimore 17-vjeçare, e cila së fundmi ka pasur një grindje në shkollë me një bashkëmoshatar, ky incident qoi deri në suspendimin e saj nga shkolla. Në shtëpi, Elira nuk ka raporte të mira nga momenti që ka folur mbi identitetin e saj gjinor. Punëtori social e ndihmon duke përdorur qasjen ekologjike/teorinë e sistemeve për të identifikuar faktorët që ndikojnë në mirëqenien e saj në gjithë nivelet e sistemeve dhe harton hapa konkret se si mund të përforcohet sistemi i mbështetjes sociale dhe ligjore. Përgjigja në raport me rastin bazuar në këtë teori do përfshinte:

•**Ndërhyrje në mikrosistem:** Ofrimi i këshillimit/informimit për familjen dhe ndërmjetësimi për përmirësimin e marrëdhënieve familjare.

•**Ndërhyrje në mezosistem:** Bashkëpunim me shkollën/arsimtarët/punëtorin social në shkollë për të garantuar një ambient të sigurt dhe për të parandaluar diskriminimin.

•**Ndërhyrje në ekzosistem:** Angazhimi i organizatave të të drejtave të njeriut për të siguruar mbështetje, kujdestar ligjor dhe strehim të sigurt në rast të përjashtimit nga shtëpia.

•**Ndërhyrje në makrosistem:** Promovimi i politikave më të mira arsimore dhe sociale për të përmirësuar mbrojtjen e të drejtave të Elirës.

## Modeli i Forcave (Strengths-Based Approach) i Saleebey (1996)

Modeli i forcave është qasje teorike praktike e punës sociale që fokusohet në fuqinë e individit, për të kapërcyer situatat e vështira që përballen (Saleebey, 1996). Si qasje ka 'personin në qendër', pra individ shihet si rezilient dhe i aftë për të u përballur me ndryshimet apo vështirësitë. Kësisoj, qasja thekson se "fuqia" e individit varet nga mënyra se si ne operojmë me mendimet tona. Në aplikim praktik, kjo qasje nënkupton që ne punojmë me klientin tonë duke inkurajuar ata të identifikojnë pikat e tyre të forta por poashtu të reflektojnë mbi faktorët rrethor të cilët mund të jenë penalizues apo rrezikues për situatën e tyre. Në këtë pikë, punëtori social identifikon pikat e forta të individit (McCashen, 2016) dhe lidh klientin me resurse të cilat janë ndihmuese për situatën e tij (Rapp et al. 2008). Kjo qasje ka disa parime dhe elemente të cilat duhet të jenë si udhëzuese për punën me klient.

Ndër to janë se punëtori social duhet **të njoh aftësitë/potencialin** e klientin, pra identifikimin e pikave të forta të cilat mund të jenë të lidhura me shkathtësitë intelektuale, të kreativitetit, artit apo edhe karakteristikave tjera personale që kanë të bëjnë me vetë-personalitetin e njeriut. Poashtu, qasja duhet të fokusohet tek **një qëllim i arritshëm** dhe këtu paraqitet **nevoja për mbështetje tek burimet tjera ndihmuese**, siq mund të jetë vendosja në kontakt me shërbime relevante për situatën e individit apo funksionalizimi i grupeve/mekanismave mbështetëse. Gjithashtu, **zhvillimi i strategjive të përballimit (coping-strategies)** është një aspekt i rëndësishëm i kësaj qasje që fokusohet në punën që bën punëtori social me klientin për të ndërtuar aftësitë për të menaxhuar situatat. Njejtë e rëndësishme është dhe **fuqizimi që bëhet përmes arsimit dhe pavarësisë ekonomike** me qëllimin për të përmisuar situatën e individit për të pasur stabilitet, por gjithmonë mbrohet parimi i vetë-vendosjes, pra vlera se individ është ai që vendos mbi jetën e tij.



# Ushtrime

## Rast studimi

Adriani është një djalë gej, inxhinier, nga një komunë e vogël në Kosovë, i cili shpeshherë ka pasur vështirësi për të gjetur punë. Së fundmi, ai është përballur me një situatë dhune dhe diskriminim në familje dhe rrethin e tij të ngushtë pasi ata e kuptuan që ai është në lidhje dashurie me një djalë. Pasi familja e përjashton nga shtëpia, ai përballlet me sfida të mëdha si mungesa e strehimit, vështirësia ekonomike dhe izolimi social. Duke përdorur modelin e forcave, punëtori social do ta ndihmonte Adrianin kështu:

Fillimisht, punëtori social **identifikon forcat e tij personale** – Punëtori social do ta ndihmonte në identifikimin e pikave të forta, psh. në rastin e lartëcekur thuhet se Adriani ka një nivel të mirë arsimimi në fushën e inxhinierisë, ku menjëherë kjo identifikohet si pikë e fortë që mund ta ndihmojnë të ndërtojë një të ardhme të qëndrueshme përmes sigurimit të punës. Pastaj, pasi që ka disa mungesa të shërbimeve sociale në nivel shteti në raport me personat LGBT+, hap i rradhës është që punëtori social **vendos Adrianin në kontakt me organizatat LGBT+** në mënyrë që rasti të merr mbështetje ligjore për të drejtat e tij dhe për të përfituar ndihmë psikologjike adekuate në përputhje me nevojat e tij. Në këtë rast, poashtu punon në **krijimin e një rrjeti mbështetës** dhe ndihmon në **mësimin e strategjive përballuese** si psh. teknikave për të menaxhuar stresin. Së fundmi, duke u nisur nga pozita e fuqizimit dhe pasi është punuar në gjithë faktorët rrezikues, punëtori social kujdeset që përmes referimit tek zyra për punësim apo qendrave të aftësisimit profesional t'i ndihmojë për të gjetur punë dhe vendbanim të qëndrueshëm.

## **Teoria e Ndërgjegjësimit ndaj Traumës (Trauma-Informed Theory)**

Teoria e ndërgjegjësimit ndaj traumës (Trauma-Informed Theory) thekson se përvoja traumatike e mëparshme ndikon në sjelljen, emocionet dhe mirëqenien e individëve. Puna sociale si profesion ka klientë të cilët ballafaqohen me një mori eventesh negative dhe trauma. Për ta kuptuar më mirë se çka nënkuptohet me traumën, atë e definojmë si një ngjarje jashtë kontrollit të personit dhe e cila shihet si kërcënim ekstrem (APA, 2013). Tek traumat, numërohen dhe mikrotraumat, pra eksperiencat e përsëritura të diskriminimit, përjashtimit ose paragjytimeve (Sue, 2007). Kjo teori promovon një qasje në punën sociale, që ka fokus mbështetjen psikologjike dhe trajtimin e klientëve duke njohur ndikimin e traumës dhe duke ndërtuar strategji që shmangin ritraumatizimin (SAMHSA, 2014).

Ideja e kësaj qasje nuk është që të adresojë traumat e kaluara por të trajtojë problemet duke pasur parasysh eksperiencat traumatike të kaluara. Poashtu, kjo metodë tenton që të krijoj një ambient të sigurtë dhe besues për klientin (Elliot et al. 2005). Prandaj, për situatën e personave LGBT+, duke jetuar në kontekste ku heteronormativiteti është norma, ata shpesh përballen me forma të shumta të dhunës dhe diskriminimit (Stotzer, 2009; Herek, 2009). Këto përvoja mund të shkaktojnë trauma që ndikojnë në shëndetin mendor, vetëbesimin, sigurinë dhe mirëqenien e përgjithshme (Russell & Fish, 2016; Meyer, 2003). Duke qenë që studimet na tregojnë se stresi që shkaktohet nga stigmatizimi, diskriminimi dhe përjashtimi i vazhdueshëm, rrit predispozitat për ankth, depresion, mendime vetëvrasëse dhe përjetim të traumave tek personat LGBT+ (Meyer, 2003) atëherë kjo qasje është metodë efektive për trajtimin e rasteve të tilla.

## Parimet Kryesore të Qasjes së Ndërgjegjësimit ndaj Traumës

Qasja e ndërgjegjësimit ndaj traumës ka disa parime që sigurojnë që qasja implementohet në mënyrë të drejtë duke respektuar mirëqenien e individit. Si parim fillestar është ai i **sigurisë** që thekson parim thekson rëndësinë e krijimit të një ambienti të sigurtë fizik dhe emocional për klientët, në këtë rast individët LGBT+. Parimi tjetër është **besimi dhe transparenca** e që ka të bëjë me komunikim konstruktiv dhe të qartë me klientin në mënyrë që të krijohet besimi mes palëve dhe rrjedhimisht të kemi rezultate pozitive në trajtim. Parimi tjetër ka të bëjë me **mbështetjen dhe fuqizimin** e që nëkupton se punëtori social duhet të ndihmojë rastet për të zhvilluar strategji/mekanizma vetë-ndihmues që ndihmojnë në ndjenjën e kontrollit mbi jetën e tyre. Parimi tjetër është **ndjeshmëria ndaj identitetit dhe përvojës** e që nënkupton njohjen e përvojave unike dhe komplekse të individëve dhe mënyrën se si ato ndikojnë në përjetimin e traumave. Qenësore për këtë parim është që të shmanget ritraumatizimi. Duke qenë që kjo qasje fokusohet në faktin se procesi i trajtimit nënkupton poashtu krijimin e një rrethi me faktorë mbështetës, parimi i fundit ka të bëjë me **ndërthurjen e qasjes me rrjete mbështetëse** që përfshin ndërlidhjen me komunitete, organizata e grupe tjera mbështetëse.

# Ushtrime

## Rast studimi

Nita është një vajzë lezbike 19-vjeçare që është dëbuar nga shtëpia pasi i ka treguar prindërve për orientimin e saj seksual. Pas linqimit nga familja, ajo ka pasur vështirësi për të gjetur strehë të sigurt, një kohë kishte mbetur e pastrehë dhe shpesh herë është bërë cak i dhunës në rrugë. Kjo përvojë negative ka pasur pasoja të shumta për Nitën pasi ajo tasht një kohë raporton sulme paniku, gjendje të keqe emocionale, ankth. Duke u bazuar në këtë qasje, punëtori social do ta ndihmonte Nitën duke pasur parasysh se ajo çfarë ka kaluar Nita ka të bëjë me traumën. Rrjedhimisht, çdo intervenim duhet të ndërtohet duke pasur parasysh të kaluarën traumatike, kësisoj, duke qenë që strehimi është problematikë e rëndësishme në këtë rast dhe nevojë bazë e Nitës, punëtori social ndihmon duke siguruar strehim (pra, **ambient të sigurt dhe mbështetës**) ku ajo ndihet e mbrojtur dhe e respektuar. Pastaj, duhet të ndërtojë **besim dhe të jetë transparent** duke i shpjeguar gjithë procesin e shërbimeve, ku gjithashtu të inkurajoj Nitën për vendimmarrje për të shmangur ndjenjën e pafuqisë, të gjitha këto bëhen në raportet me parimet etike të vetëvendosjes dhe lirisë individuale. Përgjatë gjithë intervenimit, punëtori social duhet të përdor një **qasje që nuk ritraumatizon** përsëri dhe në vend që të fokusohet vetëm te trauma e kaluar, punëtorja sociale ndihmon Nitën të identifikojë forcën dhe mekanizmat e saj vetëndihmues. Ndërsa për ta bërë rezultatin të qëndrueshëm, punëtori social mbështetet në strategji të **fuqizimit personal dhe social** ku synohet të bëhet zhvillimi i aftësive profesionale, trajnimeve, lidhja me tregun e punës dhe ofrimi i mbështetjes për strehim dhe gjetje të vendit të punës.

# Identifikimi, trajtimi dhe referimi i rasteve të dhunës në bazë gjinore për personat LGBT+

Dhuna në bazë gjinore ndaj personave LGBT+ ashtu siç u theksua përfshin lloje të ndryshme formash të abuzimit, përfshirë dhunën fizike, psikologjike, seksuale dhe ekonomike. Kjo dhunë shpesh vie si pasojë e faktorëve shoqërorë si stigma, diskriminimi, marrëdhëniet e pushtetit dhe mos funksionimi i duhur (apo mungesa) e mekanizmave të mbrojtjes ligjore (WHO, 2013). Në mënyrë që trajtimi i këtyre rasteve nga aspekti i shërbimeve sociale të jetë efektiv, institucionet dhe organizatat duhet të ndjekin praktikat më të mira të bazuara në të drejtat e njeriut, qasjen gjithëpërfshirëse dhe përgjigjes ndaj nevojave të rasteve (UNHCR, 2021).

## Identifikimi i rasteve

Duke jetuar në kontekste sociale tejte heteronormative, shpeshherë rastet e dhunës në bazë gjinore për personat LGBT+ mbeten pa u identifikuar apo raportuar për shkak të stigmës së madhe, mungesës së shërbimeve por gjithashtu edhe frikës së “daljes hapur”. Prandaj, punëtorët social duhet ta kenë të domosdoshme që në programet e trajnimeve të inkorporojnë edukimin mbi çështjet queer dhe në mënyrë që të njohin shenjat e dhunës dhe dinamikave që rrezikojnë/vështirësojnë situatat aktuale (WHO, 2013). Përveç kësaj, për personat LGBT+ është e domosdoshme që të kenë qasja në mekanizma të besueshëm për ta, rrjedhimisht për raportimin e dhunës (UNHCR, 2021) qoftë edhe përmes ndihmës/asistimit nga vetë organizatat për çështjet queer.

# Trajtimi i rasteve

Trajtimi i rasteve është efektiv atëherë kur rasti përfiton në mënyrë holistike nga shërbimet dhe kur gjithë akterët komunikojnë konstruktivisht për adresimin e rastit. Ndër themeloret në trajtimin e rasteve është sigurimi i mjedisit të sigurt, organizata WHO (2013) thekson mjedisin si një prej faktorëve kyç që duhet të kemi parasysh ku më pastaj mundësohet që rasti të ndjehet i lirë për të përfituar nga qasje në kujdes shëndetësor, shërbime psikologjike, ndihmë ligjore pa frikën e diskriminimit ose paragjykimin. Duke qenë që dhuna është situatë traumatike, mbështetja psikologjike është jetike (UN Women, 2019). Ndër format që poashtu ndihmon në ndarjen e përvojave janë grupet mbështetëse që ndihmojnë në krijimin e hapësirave të sigura për ndarjen e storjeve, krijimin e miqësive, të gjitha këto të rëndësishme për procesin e trajtimit (Herman, 1992). Gjithsesi, grupet e tilla janë në mungesë në Kosovë prandaj një ndër avokimet dhe objektivat e institucioneve/organizatave duhet të jetë gjithashtu themelimi i këtyre grupeve mbështetëse profesionale. Po ashtu, e rëndësishme në trajtimin e rasteve është mbrojtja e konfidencialitetit të rasteve, sepse shpesh, personat LGBT+ jetojnë në identitete të dyfishta dhe përballen me ekspozim (outing, ekspozim i orientimit seksual pa dëshirë) të pavullnetshëm, ku kjo situatë pastaj sjellë rreziqe potenciale nga tjerët apo edhe sjellje vetë-lënduese (UNHCR, 2021). Prandaj, nevoja për krijimin e politikave, formave dhe protokoleve të qarta për mbrojtjen e të dhënave personale dhe adresimin e rasteve është e domosdoshme në mënyrë që përfitimi nga shërbimet të jetë një përvojë unifikuese për të gjithë.

## Referimi i rasteve

Trajtimi holistik i rasteve është qenësor për arritjen e rezultateve pozitive, prandaj referimi i rasteve të dhunës ndaj personave LGBT+ kërkon një rrjet të insitucioneve/organizatave që kanë resurset adekuate për të adresuar nevojat e klientëve. Në rastin e Kosovës, shumë herë shërbimet të cilat duhen të ofrohen për të përmissuar mirëqenien e klientëve nuk ofrohen përmes mekanizmave shtetërorë, prandaj kontakti i vazhdueshëm me institucione/organizata relevante dhe rrjetëzimi me kolegët profesionistë të fushave është një prej pikave të rëndësishme në trajtimin e rasteve.



# Diskutimi

Manuali "Puna Sociale në Trajtimin e Rasteve të Dhunës me Bazë Gjinore: Personat LGBT+" trajton një tematikë të ndjeshme dhe të rëndësishme në kontekstin social dhe institucional të Kosovës, duke ofruar njohuri teorike për kuptimin e tematikës dhe duke prezantuar qasje praktike për trajtimin e rasteve të dhunës me bazë gjinore ndaj personave LGBT+. Diskutimi mbi këtë manual ndërtohet mbi manualin paraprak për punën sociale dhe menaxhimin e rasteve publikuar nga CSGD (2024), ku manuali aktual fokusohet në tematikën specifike të dhunës në bazë gjinore dhe elaboron mënyrat dhe qasjen për të garantuar mbështetje efektive dhe të qëndrueshme për rastet LGBT+.

Përmes përmbajtjes në manual, lexuesi informohet mbi kontekstin social të situatës së personave LGBT+, ku ndër vështirësitë është dhe ballafaqimi me dhunën në bazë gjinore. Korniza ligjore në Kosovë qëndron mirë në raport me mbrojtjen nga diskriminimi, por në praktikë, ka ende pengesa të rëndësishme. Frika nga paragjykimet dhe mungesa e shërbimeve sociale bën që ky grup të jetë më i predispozuar për të përjetuar dhunë dhe mospranim sociale. Në këtë kontekst, manuali synon të informojë dhe ngris shkathtësitë e profesionistëve të shërbimeve sociale për adresimin më gjithëpërfshirës të tematikës.

Manuali përfshin qasje teorike dhe modele praktike të punës sociale me të mbijetuarit e dhunës me bazë gjinore. Një prej qasjeve të përdorura është teoria e ndërthurjes (Intersectionality) (Crenshaw, 1989), e cila ndihmon në analizimin e mënyrës se si identitetet e shumëfishta—si gjinia, seksualiteti, statusi socio-ekonomik, etnia etj ndërveprojnë dhe ndikojnë në përvojat e dhunës apo diskriminimit. Ndërsa, modeli i forcave (Strengths-Based Approach) (Saleebey, 1996) tregon mbi rëndësinë e trajtimit të rasteve përmes pozitës së fuqizimit dhe reziliencës tek individët që përjetojnë dhunë. Pastaj, përmes teorive të ndryshme si teoria e sistemeve/qasje ekologjike dhe ajo e ndërgjegjësimit ndaj traumave shpalosen mënyra kritike të mendimit dhe adresimit të rasteve.

Manuali po ashtu paraqet rekomandime për mënyrat se si të përmisohet situata aktuale, ku një ndër rekomandimet është ofrimi i trajnimeve të specializuara për profesionistët e fushës, si dhe fuqizimi i sistemit të shërbimeve sociale përmes forcimit të partneriteteve mes institucioneve qeveritare, organizatave joqeveritare dhe komunitetin e profesionistëve, në mënyrë që të rritet llojllojshmëria e shërbimeve dhe përmisohet cilësia e tyre. Prandaj, pos pjesës praktike, manuali shërben si një thirrje për veprim për institucionet e Kosovës që të ndërmarrin hapa konkretë për të fuqizuar dhe përmirësuar sistemin ekzistues të mbrojtjes sociale.

## **Rekomandime për Praktikën e Punës Sociale në Kosovë**

- Përmisimi i shërbimeve sociale përmes koordinimit më të mirë midis institucioneve shtetërore, organizatave të shoqërisë civile dhe komuniteteve profesionale për të siguruar llojllojshmëri të shërbimeve që plotësojnë nevojat e rasteve.

- Profilizimi i punëtorëve socialë, ku ndër to të jenë specializimet për punën me personat LGBT+.

- Trajnime të vazhdueshme për punëtorët socialë dhe profesionistët e shërbimeve sociale që të ngrisin kapacitetet për të trajtuar raste të dhunës me bazë gjinore ndaj personave LGBT+.

- Hartimi dhe zbatimi i protokolleve standarde për trajtimin e rasteve të dhunës ndaj personave LGBT+, në mënyrë që institucionet të kenë qasje të unifikuar kur trajtojnë rastet.

Ky manual paraqet një kontribut të rëndësishëm në tematikën e trajtimit të dhunës me bazë gjinore ndaj personave LGBT+ në Kosovë. Duke interguar vlerat e punës sociale, modeleve teorike dhe praktike, manuali ofron një bazë për diskutimin e temës, zhvillimin e programeve dhe ofron mënyra praktike për adresimin e këtyre rasteve.

# Kontaktet për referim

Ndihmë ligjore falas

CEL Kosova [info@cel-ks.org](mailto:info@cel-ks.org)  
CSGD Kosova [info@csgd-ks.org](mailto:info@csgd-ks.org)

Ndihmë psikologjike falas

CEL Kosova [info@cel-ks.org](mailto:info@cel-ks.org)  
CSGD Kosova [info@csgd-ks.org](mailto:info@csgd-ks.org)

Linja për parandalimin e  
vetëvrasjes

Linja e Jetës 0800 12345  
[www.chat.linja-e-jetes.org](http://www.chat.linja-e-jetes.org)

Shërbime falas për testim  
dhe këshillim vullnetar për  
HIV, Hepatit dhe Sifiliz

CSGD Kosova  
[info@csgd-ks.org](mailto:info@csgd-ks.org)

Hapësirë e sigurt  
publike/sociale

Bubble Pub

# Referencat

Berk, L. (2000). *Child Development*. Allyn & Bacon ISBN 020530270X

Bronfenbrenner, U. (1979). *The ecology of human development: Experiments by nature and design*. Harvard University Press.

Buist, C. L., & Lenning, E. (2016). *Queer criminology*. Routledge.

Butler, J. (1990). *Gender trouble: Feminism and the subversion of identity*. Routledge.

Cookson, T. P., Fuentes, L., & Bitterly, J. (2024). Addressing gender-based violence through social protection: a scoping review. *Development in Practice*, 1–16. <https://doi.org/10.1080/09614524.2023.2290438>

Crenshaw, K. (1989). Demarginalizing the intersection of race and sex: A black feminist critique of antidiscrimination doctrine, feminist theory, and antiracist politics. *University of Chicago Legal Forum*, 1989(1), 139–167.

*Crisis Intervention Handbook: Assessment, Treatment, and Research*. (2000). Editor. Robert, A. United Kingdom: Oxford University Press.

Elliott, D. E., Bjelajac, P., FalLOT, R. D., Markoff, L. S., & Reed, B. G. (2005). Trauma-informed or trauma-denied: Principles and implementation of trauma-informed services for women. *Journal of Community Psychology*, 33(4), 461–477. <https://doi.org/10.1002/jcop.20063>

Heath, R., Hidrobo, M., & Roy, S. (2020). Cash transfers, polygamy, and intimate partner violence: Experimental evidence from Mali. *Journal of Development Economics*, 143, 102410–. <https://doi.org/10.1016/j.jdeveco.2019.102410>

Herek, G. M. (2009). Hate crimes and stigma-related experiences among sexual minority adults in the United States: Prevalence estimates from a national probability sample. *Journal of Interpersonal Violence*, 24(1), 54–74. <https://doi.org/10.1177/0886260508316477>

Herman, J. L. (1992). *Trauma and Recovery: The Aftermath of Violence—from Domestic Abuse to Political Terror*. Basic Books.

Hyman, Drew (1990) "Six Models of Community Intervention: A Dialectical Synthesis of Social Theory and Social Action," *Sociological Practice*: Vol. 8: Iss. 1, Article 5.

Llullaku, N., Selimi, R., Roest, J., & Van Der Helm, G. H. P. (2023). Kosovo sexual minorities: A mental health crisis. *Journal of Gay & Lesbian Mental Health*, ahead-of-print(ahead-of-print), 1–19. <https://doi.org/10.1080/19359705.2023.2213217>

McCashen, W. (2016, December 1). What is “the strengths approach”? Innovative Resources.

Meyer, I. H. (2003). Prejudice, social stress, and mental health in lesbian, gay, and bisexual populations: Conceptual issues and research evidence. *Psychological Bulletin*, 129(5), 674–697. <https://doi.org/10.1037/0033-2909.129.5.674>

Pandea, A.-R., Grzemny, D., & Keen, E. (2019). *Gender matters: A manual on addressing gender-based violence affecting young people* (2nd ed.). Council of Europe. <https://book.coe.int/en/youth-other-publications/8100-gender-matters-a-manual-on-addressing-gender-based-violence-affecting-young-people-2nd-ed.html>

Rapp, C., Saleebey, D., & Sullivan, P. W. (2008). The future of strengths-based social work practice. In D. Saleebey (Ed.), *The strengths perspective in social work practice* (4th ed.), Pearson Education.

Russell, S. T., & Fish, J. N. (2016). Mental health in lesbian, gay, bisexual, and transgender (LGBT) youth. *Annual Review of Clinical Psychology*, 12, 465–487. <https://doi.org/10.1146/annurev-clinpsy-021815-093153>

Russell, S. T., & Fish, J. N. (2016). Mental Health in Lesbian, Gay, Bisexual, and Transgender (LGBT) Youth. *Annual Review of Clinical Psychology*, 12(1), 465–487. <https://doi.org/10.1146/annurev-clinpsy-021815-093153>

Ryan, C., Huebner, D., Diaz, R. M., & Sanchez, J. (2009). Family rejection as a predictor of negative health outcomes in white and Latino lesbian, gay, and bisexual young adults. *Pediatrics*, 123(1), 346–352. <https://doi.org/10.1542/peds.2007-3524>

Saleebey, D. (1996). The Strengths Perspective in Social Work Practice: Extensions and Cautions. *Social Work*, 41(3), 296–305. <http://www.jstor.org/stable/23718172>

Stotzer, R. L. (2009). Violence against transgender people: A review of United States data. *Aggression and Violent Behavior*, 14(3), 170–179.

Substance Abuse and Mental Health Services Administration. (2014). SAMHSA's concept of trauma and guidance for a trauma-informed approach (HHS Publication No. SMA 14-4884). U.S. Department of Health & Human Services, marrur nga: [SAMHSA's Concept of Trauma and Guidance for a Trauma-Informed Approach | SAMHSA Publications and Digital Products](#)

Sue, D. W., Capodilupo, C. M., Torino, G. C., Bucceri, J. M., Holder, A., Nadal, K. L., & Esquilin, M. (2007). Racial microaggressions in everyday life: Implications for clinical practice. *American Psychologist*, 62(4), 271-286.

Testa, R. J., Sciacca, L. M., Wang, F., Hendricks, M. L., Goldblum, P., Bradford, J., & Bongar, B. (2012). Effects of violence on transgender people. *Professional Psychology: Research and Practice*, 43(5), 452.  
<https://doi.org/10.1037/a0029604>

UN Women. (2019). Handbook for Coordinating Gender-based Violence Interventions in Emergencies. Retrieved from [https://gbvaor.net/sites/default/files/2019-07/Handbook%20for%20Coordinating%20GBV%20in%20Emergencies\\_fin.pdf](https://gbvaor.net/sites/default/files/2019-07/Handbook%20for%20Coordinating%20GBV%20in%20Emergencies_fin.pdf)

UNHCR. (2021). Working with Lesbian, Gay, Bisexual, Transgender, Intersex Persons in Forced Displacement. Retrieved from <https://emergency.unhcr.org/sites/default/files/2024-01/Working%20with%20lesbian%2C%20gay%2C%20bisexual%2C%20transgender%2C%20intersex%20persons%20in%20forced%20displacement%2C%202021.pdf>

UNHCR. (n.d.). Protecting lesbian, gay, bisexual, transgender, intersex and queer (LGBTIQ+) persons. Retrieved from <https://emergency.unhcr.org/protection/persons-risk/protecting-lesbian-gay-bisexual-transgender-intersex-and-queer-lgbtqi-persons>

World Health Organization (WHO). (2013). Responding to intimate partner violence and sexual violence against women: WHO clinical and policy guidelines. Retrieved from <https://apps.who.int/iris/bitstream/handle/10665/329889/WHO-RHR-19.16-eng.pdf>

World Health Organization (WHO). (n.d.). Improving LGBTIQ+ health and well-being with consideration for SOGIESC. Retrieved from <https://www.who.int/activities/improving-lgbtqi-health-and-well-being-with-consideration-for-sogiesc>